

1. Të përgjithshme

- 1.1 Agjencia e Sigurimit të Depozitave (ASD) dhe qëllimi i saj.
- 1.2 Organizimi dhe drejtimi
- 1.3 Anëtarësimi në skemën e sigurimit të depozitave
- 1.4 Mbi gjendjen e sistemit bankar

2. Drejtimit kryesore të veprimtarisë së ASD

- 2.1 Kontributi fillestar
- 2.2 Primi vjetor i sigurimit dhe politikat e tij
- 2.3 Kompensimi
- 2.4 Administrimi i Mjeteve Financiare

3. Gjendja e depozitave të siguruar dhe struktura e tyre

- 3.1 Ecuria e depozitave të siguruar
- 3.2 Struktura e depozitave të siguruar
- 3.3 Struktura dhe numri i depozituesve sipas niveleve të përcaktuara në ligj

4. Gjendja financiare e ASD

- 4.1 Struktura e bilancit dhe ecuria e tij
- 4.2 Kapitali dhe ecuria e tij
- 4.3 Fitimi dhe ecuria e tij
- 4.4 Kontrolli i librave dhe i llogarive të ASD
- 4.5 Raporti i Auditit të Brendshëm

5. Një vështrim mbi veprimtaritë e tjera të ASD gjatë vitit 2007

- 5.1 Bashkëpunimi me Bankën e Shqipërisë, institucionet ndërkombëtare dhe homologët
- 5.2 Edukimi dhe informimi i publikut

6. Drejtimit kryesore të planit të zhvillimit për vitin 2008

Shkurtime

ASD	Agjencia e Sigurimit të Depozitave
IADI	International Association of Deposit Insurers
EFDI	European Forum of Deposit Insurers
FDIC	Federal Deposit Insurance Corporation
SHKK	Shoqëritë e Kursim Kreditit
FSVC	Financial Service Volunteer Corpus
FSAP	Financial Sector Assessment Program
BR	Banka Raiffeisen
BA	Banka Alpha
BASH	Banka Amerikane e Shqipërisë
BKG	Banka Kombëtare e Greqisë
BBSH	Banka e Bashkuar e Shqipërisë
BPI	Banka e Parë e Investimeve
BISH	Banka Italo Shqiptare
BKT	Banka Kombëtare Tregtare
BNT	Banka Ndërkombëtare Tregtare
BE	Banka Emporiki
BPC	Banka ProCredit
BIS	Banka Italiane e Zhvillimit
BT	Banka Tirana
BKSH	Banka e Kreditit të Shqipërisë
BP	Banka Popullore
UB	Union Bank

1. Të përgjithshme

1.1 Agjencia e Sigurimit të Depozitave dhe qëllimi i krijimit të saj

Agjencia e Sigurimit të Depozitave, është krijuar në bazë të ligjit nr.8873, datë 29.03.2002 “Për Sigurimin e Depozitave”.

Qëllimi i krijimit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave është sigurimi dhe kompensimi i depozitave të qytetarëve të vendosura në bankat që operojnë në Republikën e Shqipërisë, si anëtare të skemës së sigurimit të depozitave në Shqipëri, në bazë të kriterëve dhe niveleve të përcaktuara në këtë ligj.

Duke përmbushur detyrimet e saj ligjore cdo vit, Agjencia e Sigurimit të Depozitave plotëson misionin kryesor të saj, atë të ndikimit në rritjen e qëndrueshmërisë së sistemit bankar, forcimin e besimit tek publiku nëpërmjet shmangies së riskut të humbjes së kursimeve të tyre gjatë një falimentimi të mundshëm të ndonjë banke, duke kontribuar kështu në ruajtjen e mirëqenies ekonomike të vendit.

Agjencia e Sigurimit të Depozitave bën pjesë në institucionet që krijojnë dhe kontribuojnë në sigurinë financiare të sistemit, së bashku me Autoritetin Mbikëqyrës (Banka e Shqipërisë), dhe Ministrinë e Financave që është në funksionin e burimit të fundit financiar (*huadhenes i burimit te fundit*).

1.2 Organizimi dhe drejtimi i Agjencisë

Bazuar në ligjin nr. 8873, datë 29.03.2002 “Për sigurimin e depozitave”, Agjencia organizohet dhe administrohet nga Këshilli Drejtues dhe drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm.

Këshilli Drejtues përbëhet nga pesë anëtarë të cilët emërohen nga Banka e Shqipërisë me propozimin si më poshtë:

Dy anëtarë nga Banka e Shqipërisë,

Dy anëtarë nga Ministria e Financave,

Një anëtar nga Bashkimi Profesional i Ekspertëve Kontabël.

Drejtori i Përgjithshëm përfaqëson autoritetin ekzekutiv të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave.

1.3 Anëtarësimi në skemën e sigurimit

Anëtarësimi në skemën e sigurimit të depozitave është i detyrueshëm për të gjitha bankat që operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas nenit 3 të ligjit nr. 8873, datë 29.03.2002 “Për Sigurimin e Depozitave”, asnjë bankë nuk pranon dhe nuk grumbullon depozita kur nuk është e siguruar nga Agjencia.

Numri i bankave të siguruar nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave në fund të vitit 2007 ka qenë 17, të cilat janë banka private shqiptare apo të huaja si më poshtë:

1. Banka Italo Shqiptare
2. Banka Raiffeisen
3. Banka e Bashkuar e Shqipërisë
4. Banka Italiane e Zhvillimit
5. Banka Kombëtare Tregëtare
6. Banka Tirana
7. Dega e Bankës Kombëtare Greke Tiranë
8. Banka Ndërkombëtare Tregtare

9. Dega në Tiranë e Bankës Alpha
10. Banka Amerikane e Shqipërisë
11. Banka ProCredit
12. Banka e Parë e Investimeve
13. Banka Emporiki Shqipëri
14. Banka e Kreditit e Shqipërisë
15. Banka CREDINS
16. Banka Popullore/ Societe Generale Group
17. Union Bank

Zhvillimet pozitive sasiore e cilësore të ndodhura në sistemin bankar gjatë vitit 2007, sjellin ndryshimet e tyre edhe në skemën e sigurimit të depozitave në Shqipëri.

Në korrik të vitit 2007, me një vendim të Këshillit Mbikqyrës, Banka e Shqipërisë miratoi ndryshimin e pjesës influencuese të aksioneve në Bankën Popullore nëpërmjet shitjes së 75 përqind të aksioneve +1 tek Societe Generale Group.

Gjithashtu në dhjetor të vitit 2007, Asambletë e Aksionerëve të Bankës Italo Shqiptare dhe Bankës Amerikane të Shqipërisë aprovojnë projektin e bashkimit të të dy bankave. Ky bashkim është rezultat i iniciativës së grupit Intesa Sanpaolo që i ka blerë të dyja këto banka shqiptare dhe që synon të konsolidojë degët e tij të huaja. Emri i Bankës së re pas bashkimit do të jetë **Banka Amerikane e Shqipërisë**.

Me këtë bashkim, që bëhet efektiv vetëm në 1 Janar të vitit 2008 numri i bankave të nivelit të dytë në Shqipëri anëtare të skemës sonë që nga kjo datë do të ulet në **16**.

1.4 Mbi gjendjen e sistemit bankar¹

Viti 2007 vijon me zhvillime përgjithësisht pozitive dhe të qëndrueshme në sistemin bankar. Performanca e sistemit bankar për vitin 2007, vlerësuar në këndvështrimin e ecurisë së rezultatit neto, ka qenë dukshëm më e lartë sesa gjatë vitit 2006. Treguesit e rentabilitetit kanë nivele të mira dhe përgjithësisht rritje të qëndrueshme. Mjaftueshmëria e kapitalit është mbi nivelin minimal të përcaktuar nga Banka e Shqipërisë, përveç dy bankave që kanë zbritur poshtë këtij niveli përkohësisht.

Gjatë vitit 2007, aktivet e sistemit bankar u rritën me 118.6 miliardë lekë (ose 19 për qind). Kjo rritje vlerësohet të jetë rreth 7.1 për qind më e ulët se rritja e tyre gjatë vitit 2006.

Teprica e kredisë së sistemit bankar, gjatë vitit 2007, shënoi rritje me 94.5 miliardë lekë ose me 47.7 për qind.

Përgjithësisht vërehet një qëndrueshmëri e treguesit neto të cilësisë së portofolit të kredive (1.8 për qind nga 1.7 për qind që ka qenë një vit më parë) dhe një përkeqësim jo i konsiderueshëm i treguesit bruto si rrjedhojë e rritjes më të shpejtë të kredisë me probleme ndaj totalit të kredive (3.4 për qind ndaj 3.1 për qind).

Rezultati neto i sistemit bankar për vitin 2007 rezultoi me fitim për rreth 2,755.64 milionë lekë, rreth 18.3 për qind më shumë se viti 2006.

¹ Marrë nga vlerësimi i gjendjes financiare të sistemit bankar shqiptar, për tremujorin e katërt të 2007, analizur nga Autoriteti Mbikëqyrës

Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit për sistemin, në fund të vitit 2007 paraqitet në nivelin 17.1 për qind, duke shënuar një rënie nga 18 për qind që ishte krahasuar me fundin e vitit 2006. Kjo rënie e këtij raporti i atribuohet orientimit përherë e më të madh të sistemit ndaj aktiviteteve me rrezik.

Gjatë vitit 2007 situata e likuiditetit të sistemit bankar vazhdon të jetë e kënaqëshme. Analiza e treguesve të likuiditetit tregon se aktivet likuide zënë gati gjysmën e totalit të aktiveve. Kjo si shprehje e niveleve të mira të raporteve të likuiditetit dhe rritjes së vëllimit të depozitave.

Gjatë vitit 2007, totali i depozitave u rrit me rreth 104 miliardë lekë. Këto përbëjnë burimin parësor të gjenerimit të fondeve në sistem dhe kanë patur prirje rritëse gjatë vitit 2007.

2. Drejtimet kryesore të veprimtarisë së ASD

Agjencia e Sigurimit të Depozitave, aktiviteti i së cilës rregullohet në Shqipëri nëpërmjet ligjit nr.8873 datë 29.03.2002 “Për Sigurimin e Depozitave”, siguron depozitat e individëve në sistemin bankar, kujdeset për përfshirjen në kohë të depozituesve në skemën e sigurimit të depozitave dhe kompenson depozitat në bankat të cilave ju hiqet (revokohet) licenca nga Autoriteti Mbikqyrës (Banka e Shqipërisë) deri në një shumë të caktuar.

Aktiviteti i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave përfshin përcaktimin e primit vjetor të sigurimit për bankat e nivelit të dytë, mbledhjen e kontributit fillestar dhe primit vjetor të sigurimit, verifikimin e saktësisë së përlllogaritjes së këtij primi, investimin e mjeteve financiare, si dhe funksionin final kryesor për realizimin e detyrimit të pagesës së kompensimit të depozituesve të vegjël në bankat e nivelit të dytë që operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Në përputhje dhe me direktivën 94/19 të Komunitetit Europian për sigurimin e depozitave, Agjencia siguron të gjitha depozitat e individëve në lekë dhe monedhë të huaj, të konvertuara sipas kursit zyrtar të këmbimit të përcaktuar nga Autoriteti Mbikëqyrës në ditën e ndërhyrjes. Agjencia siguron depozitat e individëve deri në 700 mijë lekë, me afat në lekë, depozitat me afat në valutë, depozitat pa afat në lekë, depozitat pa afat në valutë, çertifikatat e depozitave në lekë, çertifikatat e depozitave në valutë etj.

2.1 Kontributi fillestar

Gjithë institucionet që ushtrojnë veprimtari bankare në Shqipëri, detyrimisht janë anëtarë të skemës së sigurimit të depozitave. Bazuar në ligjin nr. 8873, datë 29.03.2002 “Për sigurimin e depozitave”, nenin 23 të tij, çdo bankë e siguruar duhet të paguajë në Agjenci një kontribut fillestar të barabartë me 0.5 për qind të kapitalit të nënshkruar të bankës. Gjatë vitit 2007 skemës së sigurimit të depozitave në Shqipëri nuk iu shtua asnjë subjekt i ri.

2.2 Primi i sigurimit dhe politikat e tij

Bazuar në nenin 24 të ligjit nr. 8873, datë 29.03.2002 “Për sigurimin e depozitave”, për çdo bankë të siguruar, primi vjetor i sigurimit të depozitës është 0.5 për qind e mesatares aritmetike të shumës së depozitave të siguruara, të regjistruara në fund të çdo dite pune për tre muajt e fundit të vitit të kaluar. Këtë prim të pagueshëm nga bankat e siguruara, Agjencia mund ta ulë deri në 0.1 për qind, vetëm në rast se mjetet financiare të saj, do të jenë jo më pak se 5 për qind të mesatares së këtyre depozitave, veprim i cili kryhet me akt nënligjor. Ky raport aktualisht është 2.2 për qind, nga 1.9 që ishte vitin e kaluar.

Sipas nenit 24 të ligjit të mësipërm, pagesa e primit bëhet në katër këste tremujore sipas afateve të përcaktuara në ligj. Njëkohësisht me pagesën e kështit të parë, bankat sjellin pranë Agjencisë deklaratën e primit e cila konfirmon llogaritjen e primit sipas kërkesave të ligjit. Të ardhurat nga primi i sigurimit, të cilat përbëjnë dhe burimin kryesor të të ardhurave të Agjencisë, për vitin 2007 arritën në shumën 919,106 mijë lekë, të cilat krahasuar me një vit më parë kanë shënuar një rritje prej rreth 11 për qind.

Në politikat e vitit 2007 të ASD, për bankat u aplikua e njëjta normë vjetore e primit të sigurimit të depozitave të tyre, sipas dispozitave të përcaktuara në ligj. Kjo normë vjetore e pagesës së primit është e njëjtë për të gjitha bankat, për arsye se në fillimet e tyre, sistemet e sigurimit duhet të përmbushin sa më shpejt qëllimin e sigurimit të fondeve të nevojshme për rritjen e nivelit të sigurimit në të ardhmen.

2.3 Kompensimi i depozitës së siguruar

Në ligjin nr. 8873, datë 29.03.2002 “Për sigurimin e depozitave”, janë përcaktuar nivelet për kompensimin e depozitave, me nivel maksimal 700 mijë lekë, e me një aplikim të co-insurance 15 për qind të pjesës mbi 350,000 lekë. Ky nivel i shumës së mbulimit (pra të siguruar) është afërsisht dy herë më i madh se GDP per capita në vendin tonë. Duke pasur parasysh qëllimin kryesor të funksionimit të skemave të sigurimit të depozitave, i cili është krijimi i besimit të depozituesve të vegjël në këto skema dhe në sistemin bankar, kjo shumë mbulimi e justifikon këtë qëllim.

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 8873, datë 29.03.2002 “Për sigurimin e depozitave” një nga detyrat kryesore të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave është kompensimi i depozitave të siguruar sa më shpejtë të jetë e mundur, por jo më vonë se tre muaj nga dita e ndërhyrjes nga Autoriteti Mbikëqyrës në bankën e siguruar. Pra, Agjencia është institucioni përgjegjës për realizimin e funksionit final të saj, kompensimit të depozitave të klientëve në kohë reale dhe në përputhje me dispozitat e përcaktuara në ligj.

Në përmbushje të këtij funksioni, gjatë vitit 2007 u arrit një nga objektivat tona, miratimi nga Autoriteti Mbikëqyrës i “Rregullores së Kompensimit” dhe “Udhëzimit të Procedurave të Kompensimit”. Ky proces i hap rrugë fillimit të procedurave për përgatitjen e kriterëve të hartimit të termave të referencës për informatizimin e procesit të kompensimit gjatë një falimentimi të mundshëm.

2.4 Administrimi i mjeteve financiare


Bazuar në ligjin nr. 8873 datë 29.03.2002, “Për sigurimin e depozitave” neni 9, pika 2; neni 21, si dhe në dokumentin e Politikës së administrimit të mjeteve financiare të Agjencisë, Agjencia e Sigurimit të Depozitave përgjigjet për administrimin e fondeve me efektivitet dhe në përputhje me standartet e pranuar të menaxhimit të riskut. Administrimi i fondeve realizohet nëpërmjet investimit të mjeteve financiare të Agjencisë në letra me vlerë të Qeverisë Shqiptare, dhe në letra me vlerë në monedhë të huaj të qeverive, bankave qendrore dhe institucioneve të tjera financiare ndërkombëtare të vendeve të tjera, monedha e të cilave është në llogari depozitë në bankën e siguruar, me maturim të mbetur jo më shumë se një vit.

Agjencia, për të bërë një menaxhim sa më të mirë të mjeteve të saj financiare dhe për të qenë në përputhje me kërkesat e ligjit ka hartuar akte rregullative dhe ka ngritur strukturat e duhura për këtë qëllim.


Struktura e portofolit të investimit sipas maturitetit të mbetur duhet të jetë si më poshtë;

- a) 30 deri në 40 % e mjeteve financiare duhet të jenë investuar në instrumente me maturitet të mbetur jo më shumë se 3 muaj
- b) 60 deri në 70 % e mjeteve financiare duhet të jenë investuar në instrumente me maturitet të mbetur mbi 3 muaj deri në 12 muaj.

Duke mbajtur parasysh konsideratën për maturitetin, shpërndarja e portofolit sipas maturitetit me 31.12.2007 rezulton si më poshtë.



Për sa i përket strukturës së portofolit të investimeve sipas monedhave, gjatë vitit 2007 Agjencia ka ruajtur benchmarkun e përcaktuar në Politikën e administrimit të mjeteve financiare të saj në raportin 80% e portofolit në LEK dhe 20% e portofolit në monedhë të huaj duke pranuar devijimet nga benchmarku prej $\pm 3\%$.



3 Gjendja e depozitave të siguruara dhe struktura e tyre

3.1 Ecuria e depozitave të siguruara

Në fund të vitit 2007, totali i depozitave të sistemit është 621 miliard lekë, duke shënuar një rritje prej 18 për qind kundrejt fundvitit 2006. Depozitat e individëve rezultojnë përkatësisht me shumën prej 491 miliard lekë, duke zënë një peshë prej 79 për qind kundrejt totalit të depozitave në tërë sistemin bankar, prej të cilave, të siguruara janë 224 miliard lekë, të cilat të shprehura në përqindje përfaqësojnë rreth 46 për qind të depozitave të individëve. Pjesën më të madhe të depozitave të individëve e zënë depozitat në lekë dhe vetëm 39 për qind e tyre janë depozita në valutë.


Për periudhën njëvjeçare dhjetor 2006 – dhjetor 2007 vërehet një rritje prej 14 për qind e depozitave në valutë, dhe një rënie prej 7.4 për qind e depozitave në lekë (si % kundrejt totalit), e cila mund të gjejë shpjegim, nga oshilacionet e normave të interesit për depozitat në lekë, dhe tendenca e bankave të mëdha për të rritur depozitat në valutë.

Depozitat e individëve, gjatë kësaj periudhe njëvjeçare kanë shënuar një rritje prej 18 për qind, dhe ato të siguruara një rritje prej 12 për qind. Në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm jepet informacion mbi ecurinë e depozitave të sistemit gjatë periudhës 2004-2007.

Mil/lekë

Nr.	Emërtimi	Dhjetor 2004	Dhjetor 2005	Dhjetor 2006	Dhjetor 2007	Diferencat	
						5-4	6/4(%)
0	1	2	3	4	5	6	7
1.	Totali i depozitave	375,843	437,547	525,525	620,891	95,366	18
	Depozitat e kompanive	65,971	78,902	109,707	129,801	20,094	18
	Depozitat e individëve (a)	309,872	358,645	415,819	491,089	75,270	18
	Raporti (a) / tot.dep. ne %	82	82	79	79	----	----
2.	Depozitat e siguruara (b)	167,251	182,621	200,222	223,926	23,704	12
	raporti (b) / (a) ne %	54	51	48	46	----	----
	Ne lek	129,772	136,035	143,823	155,841	12,018	8
	Ne monedhe te huaj	37,479	46,586	56,400	68,085	11,685	21
3.	Depozitat e individeve jo te siguruara (c)	142,621	176,024	215,597	267,163	51,566	24
	raporti (c) / (a) ne %	46	49	52	54	----	----
	Ne lek	94,112	107,360	128,473	141,905	13,432	10
	Ne monedhe te huaj	48,509	68,664	87,123	125,258	38,135	44


Ecuria e depozitave te individeve




3.2 Struktura e depozitave të siguruar

Në tregun bankar, Banka Raiffeisen vazhdon të ketë një rol dominant, duke zotëruar 43 për qind të depozitave të siguruar të sistemit, por ky pozicion krahasuar me një vit më parë ka pësuar një rënie prej 6.5 për qind.


Ndarja e depozitave te siguruar ne %



Struktura e depozitave te individeve sipas shumes ne %



Struktura e numrit te depozitave ndare sipas niveleve te kompensimit (ne %)



Të dhënat mbi numrin e depozituesve dhe të depozitave në 31 Dhjetor 2007 krahasuar me 31 Dhjetor 2006, jepen në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Emërtimi	Gjithsej	Prej të cilave		
			Deri 350 mijë	350 – 700 mijë	Mbi 700 mijë
0	1	2	3	4	5
1.	Mbajtësit e depozitave të siguruara				
	- 31.12.2006	1,201,600	944,245	99,311	158,044
	- 31.12.2007	1,490,490	1,168,764	111,233	180,122
	% ndaj totalit				
	- 31.12.2006	100	79	8	13
	- 31.12.2007	100	80	8	12
2.	Totali i depozitave të individëve (milion Lek)				
	- 31.12.2006	415,819	38,988	50,604	326,227
	- 31.12.2007	491,089	40,966	56,964	393,433
	% ndaj totalit				
	- 31.12.2006	100	9	12	78
	- 31.12.2007	100	8	12	80

4. Gjendja financiare e ASD

Në zbatim të Ligjit nr. 8873 datë 29.03.2002, “Për Sigurimin e Depozitave” neni 28, Agjencia mban llogari dhe rregjistra me qëllim që në cdo kohë të pasqyrohet në mënyrë të saktë gjendja financiare e saj, në përputhje me ligjin “Për Kontabilitetin” si dhe Manualin Kontabël të saj të miratuar nga Këshilli i Ministrave me Vendimin Nr.250, datë 15.04.2005 “Për miratimin e Manualit Kontabël të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”. Zbatimi i këtij manuali, në mbajtjen e kontabilitetit gjatë vitit 2007 dhe në raportimin e pasqyrave financiare, ka ndikuar në një pasqyrim bashkëkohor më real e më transparent të gjendjes financiare të ASD- së, duke unifikuar në këtë mënyrë kriteret e vlerësimit dhe paraqitjes me ato të institucioneve analoge të vendeve të tjera, në respekt të kërkesave të insitucioneve kombëtare e ndërkombëtare të interesuara.

Veprimtaria financiare e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave është përjashtuar nga tatimet dhe taksat e drejtpërdrejta.

4.1 Struktura e bilancit dhe ecuria e tij

Në mënyrë të përmbledhur dinamika e Aktiveve dhe Pasiveve të Agjencisë për vitin 2007 paraqitet në pasqyrën e mëposhtme.

Treguesit kryesorë të Bilancit

Përshkrimi (ne mije leke)	31.12.2007	31.12.2006	Ndryshimi
Aktive të qëndrueshme	70.311	73.572	-3.261
Aktive korrente	4.912.925	3.830.205	1.082.720
TOTAL AKTIVE	4.983.236	3.903.777	1.079.459
Kapitali Agjencisë	4.981.826	3.902.689	1.079.137
Pasive të tjera	1.410	1.088	322
TOTAL KAPITALI & PASIVE	4.983.236	3.903.777	1.079.459

4.2 Kapitali dhe ecuria e tij


Kapitali i Agjencisë me datë 31.12.2007 është 4.981.825.656,72 lekë. Ai përbëhet nga fondi themeltar prej 400.000.000 leke, fitimi i akumuluar dhe i pashpërndarë i viteve të kaluara prej 3.502.689.127.30 lekë, si dhe fitimi i vitit ushtrimor prej 1.079.136.529,42 lekë.

PASQYRA E LEVIZJES SE KAPITALIT TE ASD

	31.12.2007	31.12.2006
KAPITALI I AGJENCISE		
• Kapitali (Fondi Themeltar)	400.000.000,00	400.000.000,00
• Kapitali (Fondi Themeltar I paguar)		
• Rezervat		
• Rezerva rivleresimi		
• Diferenca rivleresimi		
• Fitim/humbjet e pashpërndara	3.502.689.127,30	2.561.989.894.57
• Fitim/humbjet e vitit ushtrimor	1.079.136.529,42	940.699.232.73
Kapitali gjithsej i Agjencise	4.981.825.656,72	3.902.689.127.3

Kapitali i Agjencisë përbëhet nga elementët e mëposhtëm

- **Fondi themeltar**
Bazuar në Ligjin nr.8873, datë 29.03.2002, “Për Sigurimin e Depozitave”, neni 19, Fondi Themeltar i ASD-se prej 400.000.000 lekë është kontribut i buxhetit të shtetit derdhur nga Ministria e Financave në muajin shkurt të vitit 2003 .
- **Të ardhura të akumuluar**
Përfaqëson fitimin e akumuluar dhe të pashpërndarë të realizuar nga aktiviteti i Agjencisë gjatë viteve 2002, 2003, 2004, 2005, 2006 i cili rezulton në shumën 3.502.689.127.30 lekë
- **Të ardhurat e periudhës ushtrimore**
Përfaqëson fitimin e realizuar gjatë periudhës raportuese në shumën 1.079.136.529,42 lekë.



4.3 Fitimi dhe ecuria e tij

Fitimi i ASD-së në vite realizohet nga **Të Ardhurat** që përbëhen nga (a) kontributi fillestar i bankave të siguruara, (b) të ardhurat nga primi i sigurimit që bankat paguajnë pranë ASD-së (c) të ardhurat nga Operacionet Monetare si dhe (d) të ardhura nga veprimtari të tjera.

- **Krijimi i të ardhurave**


Të ardhurat e Agjencisë për periudhën raportuese përbëhen nga:

Të ardhura nga kontributi fillestar i bankave të siguruara, të cilat përfaqësojnë pagesat e kontributeve fillestare nga bankat e siguruara në përputhje me Ligjin nr.8873, date 29.03.2002 “Per Sigurimin e Depozitave”, neni 23, pika 4 e .Gjate ketij viti nuk kemi pasur te ardhura nga ky burim sepse nuk eshte futur ne sistem asnje banke e re.

Të ardhurat nga primi i sigurimit, të cilat janë të ardhurat më të rëndësishme në portofolin e ASD-së, përfaqësojnë detyrimin ligjor të bankave të siguruara per pagesen e Primit vjetor të sigurimit te depozitave për vitin 2007, në shumën prej 919.105.972,66 lekë, në zbatim të nenit 24, të Ligjit nr.8873, datë 29.03.2002 “Për Sigurimin e Depozitave”.

Të ardhurat nga Operacionet Monetare, të cilat përfaqësojnë interesat aktive nga investimi i mjeteve financiare të Agjencise, rezultojne në shumën **265.948.234,51 lekë** (të ardhura të maturuara). Këto të ardhura përbëjnë një tregues të rëndësishëm në fuqizimin e mjeteve financiare të Agjencisë. Të para në vite të ardhurat nga operacionet monetare tregojne për një qëndrueshmëri në rritje të kthimit nga investimi si dhe për një administrim të mirë dhe me efektivitet të fondeve në përputhje me standartet e pranuar të menaxhimit të riskut.

Të ardhura nga veprimtari të tjera, të cilat përfaqësojnë të ardhurat nga interesi i depozitave të vendosura pranë Bankës së Shqipërisë dhe të ardhurat nga veprimet me thesarin dhe ndërbankare janë në shumën 557.237,11 lekë.



4.4 Kontrolli i librave dhe llogarive te Agjencise

Aktiviteti i Agjencisë për vitin 2006, llogaritë dhe regjistrat e saj janë audituar nga auditimi i brendshëm. Nga ky auditim rezultoi se këto dokumenta paraqesin me vërtetësi treguesit financiarë të Agjencisë.

4.5 Raporti i Auditit të Brendshëm

Lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të vitit 2007, auditimi i brendshëm ka patur si objektivi:

- vlerësimin e besueshmërisë për informacionin financiar dhe të drejtimit dhe,
- vlerësimin mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm

Në përfundim të auditimit, opinioni për Pasqyrat Financiare të ASD është se:

Të dhënat e paraqitura në bilancin kontabël, në pasqyrën e të ardhurave, në pasqyrën cash flow dhe në pasqyrën e ndryshimit të kapitalit, pasqyrojnë në mënyrë të drejtë pozicionin financiar të ASD, performancën financiare dhe fluksin e parave në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.250 datë 15.04.2005 “Për Manualin e Kontabilitetit të ASD”. Ato janë të sakta e të plota në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike për vitin 2007.

Për sa i përket vlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, Këshilli Drejtues, Drejtoria e institucionit kanë ndërtuar infrastrukturen apo kuadrin rregullator që kanë ndikuar në menaxhimin me efektivitet të lartë të të gjithë praktikave që përbëjnë zhvillimin e aktivitetit të ASD.

Drejtoria ka ndërtuar aspekte praktike të monitorimit mbi kryerjen normale të detyrave, duke identifikuar mangësitë e brendshme dhe duke vendosur sistemin e kontrolleve financiare dhe të kontrolleve të tjera në mënyrë të tillë që ofron garanci të mjaftueshme për :

- operacione efektive dhe eficientë
- kontrolle të brendshme financiare
- pajtueshmëri me ligjet dhe rregullat .

Gjatë vitit të kaluar, ASD-ja ka siguruar tregues financiarë që e bëjnë shumë optimiste të ardhmen e misionit të saj. Situata optimiste ka edhe lidhur me realizimin e treguesve të performancës, të cilat kanë arritur gjithmonë në rritje dhe në përmirësim të ndjeshëm.

Përfundimisht, auditet brendshme shprehin opinionin, se pasqyrat financiare japin vërtetësinë e treguesve financiarë të përgatitur për vitin 2007 nga ASD.

5.Një vështrim mbi veprimtarinë e tjera të ASD gjatë vitit 2007

5.1 Bashkëpunimi me Bankën e Shqipërisë, institucionet ndërkombëtare dhe homologët

- Agjencia e Sigurimit të Depozitave si një nga hallkat kryesore që ndihmon në ruajtjen e qëndrueshmërisë së sistemit bankar, vazhdon të bashkëpunojë ngushtë me Autoritetin Mbikëqyrës (Bankën e Shqipërisë), nëpërmjet shkëmbimit reciprok të informacionit, duke konkretizuar në këtë mënyrë marrëveshjen e nënshkruar midis Bankës së Shqipërisë dhe Agjencisë së Sigurimit të Depozitave si dhe duke respektuar ligjin nr. 8873, datë 29.03.2002 “Për sigurimin e depozitave”.
- Për vitin 2007 veç të tjerash veçojmë seminarin teknik rajonal me temë mbi “Parimet e vendosjes së bankave në kujdestari dhe falimentim”, organizuar me mbështetjen financiare të Projektit FSVC.Qëllimi i seminarit ishte të ofronte një mundësi bashkëpunimi të dy institucioneve, Bankës së Shqipërisë dhe Agjencisë, për të debatuar mbi sfidat dhe zgjidhjet konkrete për problematikën që lind gjatë procesit të vendosjes së bankave në kujdestari apo falimentim të tyre, si dhe njohja me përvojën shumëvjeçare të Korporatës Federale të Sigurimit të Depozitave në SHBA në drejtim të menaxhimit të këtyre proceseve me efekte të drejtpërdrejta në stabilitetin e sistemit financiar.
- Ky seminar midis të tjerave, i shërbeu rritjes së profesionalizmit të stafit në këndvështrim të zbatimit të rregullores “Mbi procedurat dhe kriteret e zhvillimit të burimeve njerëzore”, miratuar nga Këshilli Drejtues i ASD me vendim nr. 182, datë 28.09.2007.

Në kuadrin e forcimit të kapaciteteve institucionale, FDIC në USA, Washington, i cili është një nga institucionet me përvojën më të gjatë në fushën e sigurimit të depozitave gjatë vitit 2007 i ofroi ASD-së një mundësi specializimi pranë selisë qendrore të saj.

- Agjencia gjatë vitit 2007 ka zhvilluar marrëdhëniet e saj me institucionet dhe organizmat ndërkombëtare në fushën e sigurimit të depozitave, duke kontribuar kështu në përmirësimin e dialogut midis autoriteteve dhe anëtarëve të skemës së sigurimit. Agjencia si një institucion anëtar i Organizatës Shoqata Ndërkombëtare e Siguruesve të Depozitave (IADI), merr pjesë në mënyrë aktive në komitetet e përherëshme të kësaj organizate dhe në grupet e përhershme të punës. Aktualisht, Drejtori i Përgjithshëm i saj është zgjedhur anëtar i Këshillit Ekzekutiv të kësaj organizate. Agjencia, duke qenë një nga institucionet themeluese të Forumit Europian të Siguruesve të Depozitave, i cili është rregjistruar si një shoqëri jo fitimprurëse sipas ligjit të Komunitetit Europian me seli në Bruksel, merr pjesë në mënyrë aktive në shkëmbimin e informacionit dhe eksperiencave shumëpalëshe, lidhur me çështje ndërkufitare si dhe

ndryshime të mundshme në legjislacionin europian të skemave të sigurimit të depozitave.

Pjesëmarrja e Agjencisë në organizatat ndërkombëtare të sigurimit të depozitave, i shërben harmonizimit të legjislacionit të saj sipas direktivave të Komunitetit Europian dhe paraprirjen e përshtatjes së kuadrit legjislativ të sigurimit të depozitave në Shqipëri me kerkesat e “acquis communautaire”.

- Shkëmbimi i eksperiencës dhe bashkëpunimi me vende të cilat kanë skema të ngjashme të sigurimit, ka qënë një nga prioritetet e Agjencisë për realizimin e funksioneve të saj kryesore. Kështu, në muajin Prill 2007 ASD organizoi një vizitë të disa punonjësve të saj në Fondin Bullgar, për tu konsultuar dhe marrë eksperiencën e tyre lidhur me disa ndryshime në ligjin “Për sigurimin e depozitave”.
Agjencia perfitoi komente të vlefshme lidhur me këto ndryshime edhe gjatë pjesëmarrjes në programin për kualifikimin dhe trainimin në nivele të larta ekzekutive të institucioneve të sigurimit të depozitave, organizuar nga FDIC në muajin korrik 2007 në Washington.
Po kështu ketij qellimi i sherbeu edhe vizita e nje grupi pune ne nivele te larta drejtimi nga ASD prane Fondit Francez te Garantimit te Depozitave .
- Gjatë vitit 2007 në përputhje me realizimin e matricës së objektivave të saj, ASD ka thelluar studimet mbi finalizimin e projektit të iniciativës ligjore mbi rishikimin e ligjit nr. 8873, datë 29.03.2002 “Për sigurimin e depozitave”.
Për realizimin e këtij objektiv të rëndësishëm, gjatë vitit 2007 u ndërmorën hapa konkretë ligjorë dhe institucionalë. Bashkëpunimi me Zyrën e FSVC në Tiranë (projekt i USAID), ka mundësuar asistencë ligjore të vazhdueshme lidhur me ndryshimet e propozuara nga grupi i punës i ngritur në ASD, si dhe lidhur me studimin e impaktit financiar që do të sillnin disa nga çështjet më të rëndësishme që janë pjesë e diskutimit për përfshirjen e tyre në projektin e ndryshimeve në ligjin ekzistues.
- Një projekt me rëndësi prioritarë për punën e ASD gjatë vitit 2007 është ngritja e mekanizmave për sigurimin e likuiditeteve të nevojshëm në rast falimentimi të bankave. Për këtë qëllim, ASD në vitin 2007 me mbështetjen e ekspertizës teknike të ofruar nga Zyra e FSVC në Tiranë ka kryer punën paraprake për studimin dhe identifikimin e mënyrave më eficiente për sigurimin e likuiditeteve të nevojshme, duke marrë si bazë edhe përvojat e institucioneve homologe në këtë drejtim.
- Në kuadër të aplikimit të teknologjisë bashkëkohore, gjatë vitit 2007 Agjencia bëri të mundur blerjen e programit informatik të kontabilitetit dhe financës. Ky program do të lehtësojë menaxhimin e mjeteve financiare të Agjencisë duke rritur efektivitetin e administrimit të këtyre mjeteve dhe i paraprin, së bashku me miratimin e kuadrit rregullativ, informatizimit të procesit të kompensimit gjatë ndonjë falimentimi të mundshëm.

5.2 Edukimi dhe informimi i publikut

Edukimi dhe informimi i publikut është thelbësor që një sistem i sigurimit të depozitave të funksionojë në mënyrë efektive. Edhe gjatë vitit 2007 Agjencia ka punuar në vazhdimësi për të bërë të njohur tek depozituesit skemën e sigurimit të depozitave dhe rolin e saj në procesin e kompensimit në rast të ndonjë falimentimi të ndonjë banke.

Agjencia e Sigurimit të Depozitave vazhdon të informojë depozituesit nëpërmjet kanaleve dhe mjeteve të njohura të komunikimit. Ruajtja e kontaktit të vazhdueshëm me publikun në përgjithësi dhe depozituesit e bankave të nivelit të dytë në Shqipëri, si nëpërmjet shpërndarjes së materialeve informuese si broshura shpjeguese, fletëpalosjet informuese ashtu dhe me prezencën e detyrueshme të logos së ASD në të gjitha bankat.

Duke konsideruar bankat e nivelit të dytë si një nga grupet e interesit drejtpërdrejtë të lidhura me skemën tonë dhe me depozituesit e vegjël, ASD ka shënjestruar pikërisht punonjësit e sistemit bankar si audiencë e përzgjedhur në seminarin e organizuar në 17 Dhjetor të vitit 2007, me temë “Çështje të sigurimit të depozitave në Shqipëri”, në bashkëpunim me Shoqatën e Bankave në Shqipëri.

Qëllimi i organizimit të këtij takimi pune informues e edukues ishte:

- Thellimi i njohurive të punonjësve të bankave të nivelit të dytë mbi rolin e ASD në sigurimin e depozitave, ruajtjen e stabilitetit financiar të vendit, mbrojtjen e depozituesve dhe forcimin e besimit të publikut në këtë skemë.
- Forcimi i dialogut midis Agjencisë dhe bankave të siguruara si anëtare të skemës së sigurimit të depozitave në Shqipëri.

6. Drejtimet kryesore të planit të zhvillimit për vitin 2008

1. Agjencia do të vazhdojë të fokusojë planin e saj të zhvillimit, gjatë vitit 2008 në drejtim të hartimit e zbatimit të politikave të edukimit të publikut e të zhvillimit strategjik të burimeve njerëzore dhe finalizimit të projekteve për përmirësimin e kuadrit ligjor e nënligjor .
2. Finalizimi i iniciativës ligjore të ASD për disa ndryshime në ligjin e sigurimit të depozitave është parashikuar si objektivi kryesor i ASD për vitin 2008 dhe për këtë qëllim do të bashkëpunohet ngushtë me Autoritetin mbikqyrës, si dhe me të gjithë institucionet që veprojnë, si rregullatorë apo që ushtrojnë veprimtari në tregun bankar.
3. Finalizimi i projektit të sigurimit të likuditetit për ASD, negocimi me Ministrinë e Financave dhe Bankën e Shqipërisë për kushtet që do të përmbajnë këto marrëveshje është përcaktur si një nga objektivat kryesorë të punës për vitin 2008. Ngritja e këtyre instrumenteve ligjorë do të plotësojë kuadrin e masave institucionale për përballjen dhe menaxhimin e situatave të falimentimit të bankave, si dhe do të ndikojë në rritjen e besimit të publikut në sistemin bankar.

BILANCI PERMBLEDHES
Per periudhen 01.01.2007 deri me date 31.12.2007

Ne leke

	N 31.12.2007	N-1 31.12.2006
A		
MJETE Monetare dhe ekuivalentet e tyre	19,625,637.78	170,030,709.90
1- Mjete monetare prane B. Shqiperise	15,702,615.12	1,932,054.49
2-Ekuivalente te mjeteve monetare	0.00	0.00
3- Llogari administrative prane bankave	3,923,022.66	168,098,655.41
* ne leke (Raiffeisen Bank)	492,659.04	386,925.52
* ne leke (BKT Tirana 3)	454.78	1,162,661.20
* ne valuta (RaiffeisenBank)	1,695,660.06	353,553.50
* ne valuta (BKT Tirana 3)	310,799.40	542,676.90
* ne valuta (State Treet Bank)	1,423,449.38	165,652,838.29
4- Arka	0.00	0.00
B		
Investime ne letra me vlere te Qeverise	4,646,858,825.43	3,430,155,074.10
1- Investime ne LVL te Qeverise Shqiptare	3,943,116,500.00	2,986,732,393.00
2- Investime te LVL te Qeverive te Huaja	830,647,697.43	509,603,870.10
3- Interes i Arketueshem (Bono Thesari)	-126,905,372.00	-66,181,189.00
C		
Llogari te Arketueshme	246,439,862.61	230,019,340.80
1- Prime te arketueshme	229,616,719.00	207,174,659.00
2- Interes i perlog si e ardhur (LVL)	16,743,407.61	20,003,046.57
3- Kerkesa per arketim ndaj Bankave te falimentuara	0.00	0.00
4- (-) Zhvleresimi i kerkesave per arketim	0.00	0.00
5- Skonto, cmimi, primi LVL	0.00	2,761,899.23
6- Te tjera te arketueshme (debitore)	79,736.00	79,736.00
D		
Aktive te tjera	70,311,469.90	73,572,297.50
1-Aktive te Qendrueshme	69,100,871.60	72,701,211.10
a- Aktive te Qendrueshme te Patrupezuara	1,083,600.00	0.00
b- Aktive te Qendrueshme te Trupezuara	89,644,037.30	89,644,037.30
(-) Zhvleresim i Akumuluar i AQ	-21,626,765.70	-16,942,826.20
2- Materiale	1,078,957.30	726,057.40
3- Shpenzime per tu shperndare	131,641.00	145,029.00
TOTALI	4,983,235,795.72	3,903,777,422.30
Llogari Jashte Bilancit	0.00	0.00
Kerkesa per arketim	0.00	0.00
Te tjera llogari angazhimesh	0.00	0.00

Ne leke

	DETYRIMET DHE KAPITALI (PASIVET)	N 31.12.2007	N-1 31.12.2006
A	DETYRIME	1,410,139.00	1,088,295.00
	I. Detyrime Afat shkurtra	1,410,139.00	1,088,295.00
	1. Kompensimi I depozitave te siguruara		0.00
	2. Detyrime Sigurime Shoqerore	272,182.00	313,542.00
	3. Tatim te ardhurat Personale	326,821.00	328,617.00
	4. Te tjera	811,136.00	446,136.00
	* te tjera (gjoba te paarketuara)	79,736.00	79,736.00
	* te tjera (Furnitor)	427,000.00	0.00
	* Te tjera te ngjashme (shpez te llogaritura))	165,000.00	227,000.00
	*te tjera (% te kontratave)	139,400.00	139,400.00
	2.Kred/ Hua Afatshkurtra		
	II. Detyrime Afatgjata	0.00	0.00
	1. Kredi/Hua Afatgjata	0.00	0.00
	2. Kreditore te tjere	0.00	0.00
	III. Provigjone	0.00	0.00
	1. Provigjone te pergjitheshme	0.00	0.00
	2. Provigjone per humbje nga falimentimi	0.00	0.00
	3. Provigjone te tjera	0.00	0.00
B	TE ARDHURA TE MARA NE AVANCE	0.00	0.00
C	SUBVENCIONE DHE DONACIONE	0.00	0.00
D	FONDE	4,981,825,656.72	3,902,689,127.30
	I. Fondi themeltar (kapitali I themelimit)	400,000,000.00	400,000,000.00
	II. Rezervat		
	III. Fondi I Akumuluar	3,502,689,127.30	2,561,989,894.57
	IV. Fitimi dhe Humbja (-) e vitit Ushtrimor	1,079,136,529.42	940,699,232.73
	TOTALI (A+B+C+D)	4,983,235,795.72	3,903,777,422.30
	LLOGARI JASHTE BILANCIT		
	Te ardhura ne pritje per arketim	0.00	0.00
	Te tjera llogari angazhimesh	0.00	0.00
	PASIVET GJITHSEJ	4,983,235,795.72	3,903,777,422.30

PASQYRA E TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE

(per periudhen 01 Janar deri 31 DHJETOR 2007) (ne leke)

N R	PASQYRA E TE ARDHURAVE (ne leke)	N	N-1
		31.12.2007	31.12.2006
	TE ARDHURA GJITHSEJT A + B + C + D + E		
	Nga keto:	1,185,611,480.28	1,024,052,427.32
A	Nga veprimtaria e sigurimeve	919,121,000.80	834,695,653.31
	1. Te ardhura nga Kontributi fillestar	0.00	4,984,000.00
	2. Te ardhura nga primet	919,105,972.66	828,896,525.58
	3. Te ardhura te tjera qe lidhen me to		
	* per veprimet me thesarin dhe nderbankare	15,028.14	144,463.73
	* per veprimet me klientet		670,664.00
B	Nga veprimtarite operative	266,490,479.48	189,356,774.01
	1. Te ardhura nga interesi I depozitave	542,244.97	0.00
	2. Te ardhura nga interesi I Letrave me Vlere	265,948,234.51	189,356,774.01
	a- te Qeverise Shqiptare	230,311,107.00	158,772,388.00
	b. te Qeverive te Huaja	32,317,966.21	30,584,386.01
	c. te ardhura te tjera qe lidhen me to	3,319,161.30	0.00
	3. te ardhura te tjera qe lidhen me to (rivleresim te LVL)	0.00	0.00
C	Rimarje provigjonesh	0.00	0.00
D	Te ardhura nga falimentimi	0.00	0.00
E	Te ardhura te tjera	0.00	0.00
1	TOTALI A+ B+ C+ D+ E	1,185,611,480.28	1,024,052,427.32
A	Shpenzime Operative	23,127,169.95	25,729,508.45
	1. Shpenzime materiale dhe te ngjashme	10,919,159.46	9,197,417.72
	2. Shpenzime financiare	7,524,070.99	11,174,338.33
	a. interesa per Kredi/Huate (kom)	0.00	0.00
	b. komisione bankare	1,579,556.28	1,584,881.87
	c. te tjera (te paparashikuara)	0.00	0.00
	d. shpenzime per zhvleresim te LVL	5,944,514.71	9,589,456.46
	3. Amortizimi I Aktiveve te Qendrueshme	4,683,939.50	5,357,752.40
	4. Kuota e shpenzimeve per t'u shperndare	0.00	0.00
	5. Te tjera		0.00
B	Shpenzime Personeli	23,916,074.00	25,724,565.00
	1. Paga + shperblime	20,886,783.00	22,164,766.00
	2. Sigurime shoqerore	2,262,126.00	3,136,816.00
	3. Te tjera te ngjashme	767,165.00	422,983.00
C	Tatime Taksa e te ngjashme	0.00	0.00
D	Provigjone	0.00	0.00
E	Te tjera operative	3,246,572.00	2,527,491.00
	Shpenzime Bordi	3,246,572.00	2,527,491.00
F	Shpenzime Falimentimi	0.00	0.00
G	Shpenzime te periudhave te kaluara	0.00	0.00
H	Shpenzime te paparashikuara	784,220.00	0.00
K	Te tjera	0.00	0.00
	TOTALI A+ B + D + E + F + G + H + K	51,074,035.95	53,981,564.45
E1	Te tjera operative (diferenca konvertimi)	55,400,914.91	29,371,630.14
	Diferenca rivleresimi (renia e kursit) per 07	29,243,134.91	3,330,499.14
	Diferenca rivleresimi te LVL te 2006(renie e kursit)	26,157,780.00	26,041,131.00
2	TOTALI A+ B + D + E + F + G + H + K+E1	106,474,950.86	83,353,194.59
	REZULTATI	1,079,136,529.42	940,699,232.73

AGJENCIA SIGURIMIT TE DEPOZITAVE

PASQYRA E RRJEDHJES SE PARASE

(Per daten 31.12.2007)

(ne Leke)

	PASQYRA E RRJEDHJES SE PARASE	31.12.2007 N	31.12.2006 N-1
1	AKTIVITETE OPERATIVE		
	* Prime te arketuara	919,105,972.66	832,747,011.73
	* Kerkesa te arketuara	-	4,984,000.00
	* Hua te mara		-
	* Te ardhura nga interesi	265,948,234.51	189,356,774.01
	* Te tjera shuma te arketuara	557,273.11	815,127.73
	* Pagesa per punonjesit	- 24,001,531.00	- 25,849,565.00
	*Pagesa ndaj Furnitoreve	- 2,916,617.00	- 25,604,508.45
	* Te tjera pagesa	- 13,484,164.16	- 4,501,233.07
	Fluksi I parave nga Aktivitetet Operative	1,145,209,168.12	971,947,606.95
2	AKTIVITETE INVESTUESE		
	* Blerje e Aktiveve te Qendrushme (materiale)	- 1,442,899.30	- 444,282.60
	* Blerje e letrave me Vlere	- 1,277,427,933.33	- 791,337,783.10
	* (Interes i arketueshem)	- 16,743,407.61	- 20,003,046.57
	* Depozita afatgjate		
	* Shitje e Letrave me Vlere	-	-
	* Arketime nga shitja e AQT	-	-
	Fluksi I Parave nga Aktivitete Investuese	- 1,295,614,240.24	- 811,785,112.27
	Rritja (Pakesimi) neto i parase gjate Vitit (1 +2)	- 150,405,072.12	160,162,494.68
	Gjendja e parase ne fillim te vitit	170,030,709.90	9,868,215.22
	Gjendja e parase ne fund te vitit	19,625,637.78	170,030,709.90